



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 108/13
Prishtinë, më 22.05.2013, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Jelena Bontic, Sevdije Lama, Hykmete Bajrami, Hasime Krasniqi, Sali Asllanaj, Albana Fetoshi dhe Xhevdet Neziraj.

Munguan: Naser Osmani, Latif Gashi dhe Duda Balje.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Luljetë Krasniqi, Dashurije Canolli.

Gjithashtu ishin të pranishëm: Ruzhdi Jashari dhe Bujar Sadiku nga AMDHP, Ismet Krasniqi – sekretar i Kuvendit, Ramadan Islami, Rejhane Zylfijaj nga GIZ.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Rishqyrtimi i Raportit financiar vjetor të Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2012;**
- 3. Shqyrtimi i kërkesës për mbulimin e shpenzimeve për mbajtjen e Lutjeve të Mengjesit në Kosovë;**
- 4. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit Hetimor Parlamentar për lejimin e mjeteve buxhetore;**
- 5. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja konstatoi se rendi i ditës miratohet njëzëri.

2. Rishqyrtimi i Raportit financiar vjetor të Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2012

Kryetarja theksoi se Agjencia ka sjellur të dhënat shtesë siç janë kërkuar nga komisioni lidhur me planifikimin e shpenzimeve.

Ruzhdi Jashari theksoi se Agjencia sipas rekomandimeve të Komisionit, ka sjellur raportin shtesë financiare me të dhëna e plotësuar ashtu siç është kërkuar.

Hasime Krasniqi meqenëse agjensioni e ka sjell raportin siq e kemi kërkuar atëher unë propozoj ta hudhim në votim.

Kryetarja e kemi këtu zyrtarin kryesorë do të ishte mirë të na sqaroj se ku jemi me legjislacionin sekondar dhe kur pritet që ky institucion të filloj me inkasimin e të hyrave.

Ruzhdi Jashari e nuk jemi të akomoduar me kapacitete udhëheqëse, por mbështetjen në shpenzimet tona dhe në aspektet financiare po i shfrytëzojm të gjykatës kushtetuese meqë i kemi afër si institucion për të mos bërë lëvizje të kosta punëtorët. Unë mund të kuptoj një informacion se inkasimin e parë të të hyrave ne do ta kemi këtë vit dhe këtë do ta kemi hyrje 10.000 euro nga Norvegjia ndërkaq qështja e imputeve tjera hyrëse në rast se vendimet e agjensisë nuk janë të zbatueshme ku ne i kemi lëshuar dhe kemi ndërmarrur veprime direkte ne terren.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin financiar vjetor të Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2012.

3. Shqyrtimi i kërkesës për mbulimin e shpenzimeve për mbajtjen e Lutjeve të Mengjesit në Kosovë

Kryetarja është një kërkesë që është bërë nga kryetari i grupit parlamentar të PDK-ës Adem Grabovci dhe deputeti i LDK-ës Lutfi Haziri. Me qënëse kërkesa i është bërë Kryesisë së Kuvendi, unë nuk e kam shumë të qartë pse është kërkuar që një kërkesë e tillë të shqyrtohet në Komisionin për buxhet dhe financa.

Ismet Krasniqi ky është një përfundim i Kryesisë së Kuvendit i cili është parë nga ana e organizatorëve të ashtuquajturit manifestimit Lutjet e mëngjesit i cili manifestim organizohet nën patronatin e pjesshëm të Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës. Për realizimin e këtij manifestimi është paraparë një buxhet orientues afër 100.000 euro, dhe është menduar që të shkoj në participim 50% Kuvendi dhe 50% Qeveria. Kryesia e ka adresuar kërkesën deri te Komisioni për buxhet dhe financa, janë disa mjete që nuk janë të parapara në buxhet si zë buxhetor për vitin 2013. Duke pas parasysh se është një manifestim me një pesh shumë të madhe sepse parashihet të jenë prezent njerëz eminent nga vendet më të mëdha të botës. Është kërkesë që të jetë komisioni në dijeni se kjo shumë e mjeteve në mënyra të caktuara gjatë 6 mujorit të dytë t'i kthehen Kuvendit.

Sali Asllanaj nëse lutjet e mëngjesit e meritojnë një organizim të tillë atëher është dashur të parashihen me kohë në buxhet të Kosovës që të mos kemi probleme të tilla. Unë më shumë do të doja të ndëgjoja bazën ligjore të një veprimi të tillë që po e diskutojmë këtu në komision se sa kërkesa. Unë mendoj që të mësohemi që të mos ngutemi ti planifikojmë dhe atë qka kemi planifikuar ta realizojmë. Nëse lutjet e mëngjesit nuk janë mbajtur deri në këtë vit atëher mund ta shtyejmë këtë manifestim deri në vitin 2014, e planifikojmë në buxhet dhe e realizojmë, mos të ngutemi nuk është ndonjë gjë që duhet patjetër ta bëjmë.

Kryetarja neve në kuadër të buxhetit të Kuvendit nuk kemi ndonjë pozicion për shpenzimet e pa parashikuara siq është rasti. Kjo është një ngjarje e rëndësishme sepse vijnë përfaqësues nga vende të ndryshme të botës dhe nuk është paraparë që të mbahet në Kosovë, është mirë që po mbahen në Kosovë dhe interesi jonë nuk është që ne të dështojmë si shtet në një takim të tillë. Mirëpo organizatori i kësaj ngjarje është dashur që të bëjë një plan se sa mjete i duhen meqenëse organizimi është nga Kuvendi dhe aty janë të përfaqësuara të gjitha grupet parlamentare dhe marrin pjesë në këtë organizim që kërkesa në Komision të vije me kohë. Sekretari theksoi se është mundësia e sigurimit të mjeteve nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve për ne është me rëndësi që të respektohen të gjitha procedurat ligjore për ndarjen e këtyre mjeteve dhe më tutje të shikohet arsyeshmëria e kërkesave të Kuvendit në mënyrë që Kuvendi të funksionoj pa ndonjë problem sa i përket mjeteve financiare.

Ismet Krasniqi ne për momentin mund ti sigurojmë këto mjete sepse në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve për vitin 2013 mund të shmanget 50.000 euro por problemi është te rikthimi i këtyre mjeteve qoftë nga Qeveria, qoftë nga rishikimi i buxhetit. Si Komision buxhetor të cilit i raportojmë shpenzimet tona, unë kam dashur që të njoftojmë Komisionin. Ndërsa si mbështetje të aktivitetit kemi marrë të gjitha instruksionet të gjitha sygjërimet se aktiviteti duhet të realizohet në bazë të një skenari i cili është miratuar nga vendimmarrja politike do të thotë ne nuk mund ta fenojmë.

Xhevdet Neziraj është një ngjarje me rëndësi për arsye se do të ketë delegacione të ndryshme dhe Kosovës për momentin i duhet të organizojë diqka të tillë nga gjithë kjo dalim me diqka pozitive edhe për investime edhe për njohje të reja mirëpo atë qka e thatë dhe ju është problemi se Kryesia pasi ka marr vendim atëherë veq po kërkon të jetë një bekim i Komisionit dhe sekretari tha shumë qart që njëfar forme këta do ti japin 50.000 euro me një besim që të rikthehen. Ndoshta do të ketë shpenzime më të vogla sepse po e shoh këtu një laps 0.60 euro cent unë pak më parë, e blejta 0.10 cent mendoj që mund të ulen shpenzimet.

Kryetarja sa po e shoh unë këta kanë dashur të na njoftojnë ne si Komision sepse unë po shoh me një shkresë tjetër që sapo erdhi se Kryesia e ka marr vendimin ku mirren mjetet nga administrata për mbulimin e këtij aktiviteti dhe po e përfundojmë këtë qështje, rekomandojmë administratën dhe kryesinë e Kuvendit që t' respektojnë procedurat ligjore.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

Administrata e Kuvendit të Kosovës të bëjë ndarjen e mjeteve nga buxheti i Kuvendit sipas Vendimit Nr.04-V-354 të datës 20 maj 2013 të Kryesisë së Kuvendit, në shumën prej 50,000€, për mbulimin e shpenzimeve për mbajtjen e Lutjeve të Mëngjesit në Kosovës, në pajtim me ligjet në fuqi.

4. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit Hetimor Parlamentar për lejimin e mjeteve buxhetore

Kryetarja kemi kërkesën e Komisionit hetimor për lejimin e mjeteve buxhetore, këtë kërkesë e kemi pasur dhe në dy takime tjera mirëpo ne e kemi shtyrë për shkak të mos prezencës së sekretarit.

Ismet Krasniqi komisionet e përhershme të Kuvendit të Kosovës kanë një buxhet vjetor 10.000 euro ndërsa Komisionet profesionale kanë një buxhet vjetor 5000 euro. Sipas ligjit për hetim parlamentar, ky komision krahasohet me Komisionet e përhershme, që do të thotë se i takon një buxhet prej 10.000 euro. Prandaj rekomandoj Komisionit, që të deklarohet se Komisioni hetimor ka të drejtë për një buxhet 10.000 euro siç e kanë Komisionet e përhershme, ndërsa të gjitha kompenzimet për anëtarët dhe shpenzimet tjera të bëhen komform me vendimet e Kuvendit. Ndëkaq qëshjta e kompensimit të stafit për

punët shtesë, është e rregulluar me Rregulloren për orarin e punës dhe kompensimet nëpunësit civil të administratës së Kuvendit, ku janë paraparë shtesat dhe mendoj se duhet trajtuar konform kësaj rregullore.

Kryetarja ne e kemi edhe një ligj për Komisionet hetimore që është miratuar në Kuvend dhe duhet t'a kemi parasysh edhe ligjin në këtë rast.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

- I. Të miratohet buxheti i Komisionit Hetimor Parlamentar në shumë prej 10,000 (dhjetëmijë) Euro, në pajtim me nenin 11, paragrafi 5 të Ligjit për Hetim Parlamentar.
- II. Kompensimi i anëtarëve të Komisionit Hetimor Parlamentar, të bëhet në pajtim me Vendimin nr.04-V-079 të datës 10 tetor 2011 për caktimin e lartësisë së kompensimit të deputetit për funksion udhëheqës dhe kompensimin e shpenzimeve mujore.

5. Të ndryshme.

5.1. Kryetarja njoftoi anëtarët se Misioni i Fondit Monetar Ndërkombëtar është në Kosovë prej datës 28.05 deri në 10.06.2013, në takimet e rregullta me institucionet përkatëse. Me datën 03.06.2013 është paraparë dy takime, ku janë të ftuar Ministria e Financave, Banka Qendrore dhe anëtarët e Komisionit për buxhet dhe financa. Takimi mbahet në ndërtesën e Qeverisë. Për më tepër të dhënat i gjeni në agjenden që do të iu dërgohet në formë elektronike nga stafi.

5.1. Kryetarja meqë Projekligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike është miratuar në parim në Kuvend, propzoi të caktohet grupi punues. Sipas propozimit, Komisioni caktoi grupin punues për shqyrtimin e Projekligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike, me këtë përbërje: Safete Hadergjonaj, Sali Asllanaj, Xhevdet Neziraj, Jelena Bontic dhe Albana Fetoshi.

Mbledhja përfundoi: 11:10.

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesja e Komisionit

Safete HADERGJONAJ